

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

PËR

DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 64/2012 “PËR PESHKIMIN”, TË NDRYSHUAR

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji është përditësimi dhe përafrimi me legjislacionin e ri ose të ndryshuar të Bashkimit Evropian në fushën e peshkimit, rregullimi dhe përmirësimi i dispozitave lidhur me infrastrukturën e peshkimit, mënyrës së menaxhimit dhe transferimit të saj, si dhe rishikimi i nivelit të masave për sanksionet e parashikuara.

Ligji Nr. 64/2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar, përafron një numër Rregulloresh të BE-së, Rregulloren e Këshillit Nr. 1224/2009/KEE; Rregulloren e Këshillit Nr. 2371/2002/KE; Rregulloren e Këshillit Nr. 1967/2006/KE; Rregulloren e Këshillit Nr. 1198/2006/KE; Rregulloren e Këshillit Nr. 1005/2008/KE; Rregulloren e Këshillit Nr. 104/2000/KE etj.

Disa nga këto rregullore janë shfuqizuar nga Rregullore të tjera të BE-së, sikurse ato që janë akoma në fuqi kanë pësuar amendime dhe shtesa, një pjesë e të cilave duhet të reflektohen edhe në Ligjin Nr. 64/2012, si dhe në aktet e tjera nënligjore. Megjithëse, disa nga rregulloret e mësipërme janë shfuqizuar, konceptet janë mbartur në rregulloret e reja dhe riformulimi i neneve të propozuar në këtë draft-ligj, ka për qëllim rritjen e shkallës së përafrimit të tyre me rregulloret përkatëse të BE-së.

Përveç rritjes së shkallës së përafrimit, objektivat që synohen të arrihen me miratimin e këtij projektligji janë gjithashtu zhvillimi i mëtejshëm i sektorit të peshkimit dhe kjo natyrisht lidhet me të gjithë zinxhirin deri në përpunim.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të vitit 2024 dhe në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian të vitit 2024, për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Projektligji është në përputhje me “Strategjinë Ndërsektoriale për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027”, miratuar me Vendimin Nr. 460, datë 29.6.2022, të Këshillit të Ministrave, lidhur me objektivin e përgjithshëm: “Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm të peshkimit detar dhe të ujërave të brendshme” e cila bazohet në Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) të Agjendës së OKB-së 2030, për të ruajtur dhe përdorur në mënyrë të qëndrueshme Detin Mesdhe dhe burimet detare për zhvillim të qëndrueshëm.

Projektligji është në përputhje edhe me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Gjatë procesit të *screening*, në shtator të vitit 2023, sikurse edhe në mbledhjet e zhvilluara midis komisionit dhe grupit të punës të Kapitullit 13, u evidentuan disa përditësime që nevojiten në legjislacionin e peshkimit, nga të cilat një pjesë e tyre kërkojnë ndryshimet e ligjit dhe pjesa tjetër do të ndryshohen në aktet nënligjore përkatëse.

Objektivat dhe prioritetet e Politikës së Përbashkët të Peshkimit të BE-së (Rregullore Nr. 1380/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit në lidhje me Politikën e Përbashkët të Peshkimit), janë ndër të tjera:

- Garantimi që aktivitetet e peshkimit dhe akuakulturës të jenë të qëndrueshme nga pikëpamja mjedisore, në periudhë afatgjatë dhe të menaxhohen në përputhje me arritjen e objektivave të përfitimeve ekonomike, sociale dhe të punësimit, sikurse kontribuojnë në disponueshmërinë e furnizimit me ushqim;

- Zbatimi i qasjes së kujdesshme të menaxhimit të peshkimit, që ka për qëllim të sigurojë shfrytëzimin e burimeve të gjalla detare biologjike dhe të shërbejë për mbajtjen e popullatave të specieve të zëna, mbi nivelet e afta, për të prodhuar rendimentin maksimal të qëndrueshëm;
- Aplikimi i qasjes së bazuar në ekosistem, në menaxhimin e peshkimit, për të siguruar që aktivitetet e peshkimit të kenë një ndikim minimal negativ në ekosistemet detare dhe të sigurojnë që akuakultura dhe aktivitetet e peshkimit të shmangin degradimin e mjedisit detar.

Anijet shqiptare të peshkimit mund të zhvillojnë aktivitetet jashtë Mesdheut dhe peshku i zënë kudo në botë është peshk shqiptar pasi varet nga flamuri i anijes së peshkimit. Që anijet të zhvillojnë aktivitet në detrat e largët, jashtë Mesdheut, nevojitet që këto anije të jenë më të mëdha dhe të pajisura me aparaturat që mundësojnë lundrimin në distanca të largëta. Për këtë qëllim është e nevojshme të krijohet mundësia që ligji i peshkimit të lejojë futjen e anijeve të reja për peshkim jashtë Mesdheut, ashtu sikurse edhe vetë vendet e BE-së e kanë për flotën e tyre Rregulloren e BE-së 2017/2403 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 12 dhjetor 2017 mbi menaxhimin e qëndrueshëm të flotës së jashtme të peshkimit dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 1006/2008.

Shqipëria është palë kontraktuese e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtën e Detit të 10 dhjetorit 1982 (UNCLOS), miratuar me Ligjin Nr. 9055/2003. Kjo dispozitë ndërkombëtare përcakton parimin që të gjitha shtetet duhet të miratojnë masat e duhura për të siguruar menaxhimin dhe ruajtjen e qëndrueshme të burimeve detare dhe për të bashkëpunuar me njëri-tjetrin për këtë qëllim.

Shqipëria ka pranuar Marrëveshjen për të nxitur respektimin e masave ndërkombëtare të ruajtjes dhe menaxhimit nga anijet e peshkimit në det të hapur të 24 nëntorit 1993 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë, miratuar me Ligjin Nr. 9401/2005. Kjo Marrëveshje parashikon që një palë kontraktuese nuk duhet të lëshojë leje për të përdorur një anije për peshkim në det të hapur nëse disa kushte nuk plotësohen, si dhe të zbatojë sanksione nëse disa detyrime raportimi nuk përmbushen.

Shqipëria ka miratuar Planin Ndërkombëtar të Veprimit të FAO-s për të parandaluar, penguar dhe eliminuar peshkimin e paligjshëm, të paraportuar dhe të padeklaruar ('IPOA-IUU') të miratuar në vitin 2001. IPOA-IUU dhe Udhëzimet Vullnetare të FAO-s, për performancën e shtetit të flamurit, të miratuara në 2014 nënvizojnë përgjegjësinë e shtetit flamur për të siguruar ruajtjen afatgjatë dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve të gjalla detare dhe ekosistemeve detare. IPOA-IUU parashikon që një shtet flamur duhet të lëshojë leje/autorizime për të peshkuar në ujërat jashtë sovranitetit ose juridiksionit të tij për anijet që mbajnë flamurin e tij.

Parimi kryesor i këtij propozimi është që çdo anije shqiptare që peshkon jashtë ujërave territoriale duhet të pajiset me leje dhe rrjedhimisht t'i nënshtrohet mbikëqyrjes nga shteti shqiptar, flamurin e të cilit anija mban kudo që operon dhe pavarësisht nga kuadri në të cilin zhvillohen aktivitetet e tij. Dhënia e një leje peshkimi duhet t'i nënshtrohet pajtueshmërisë me një sërë kriteresh të përshtatshmërisë.

Ndryshimi i propozuar prek vetëm disa nene të Ligjit Nr. 64/2012 “Për peshkimin”, i ndryshuar. Ky ndryshim nuk prek thelbin e ligjit dhe mundëson përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit.

Përveç procesit të përafrimit, gjithashtu ndryshimi i propozuar mundëson zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të peshkimit dhe kjo natyrisht lidhet me të gjithë zinxhirin deri në përpunim. Rritja e sasisë së peshkut të zënë do të reflektohet kryesisht në rritjen e eksporteve “Made in Albania”. Deti Mesdhe, përgjithësisht është një det me pak resurse peshkore dhe përgjithësisht me këto resurse të mbi peshkuara. Zonat kryesore në botë, të cilat për arsye natyrore dhe të një kombinimi të shumë faktorëve oqeano-grafike shquhen për një bollëk të resurseve peshkore dhe do të jenë një mundësi rritjeje të sektorit të peshkimit, të eksporteve shqiptare dhe të të ardhurave në ekonominë vendase.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji hartohet në përputhje me nenet 78 dhe 81, pika 1 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS E BE-SË (PËR PROJEKTAKTEET NORMATIVE)

Projektligji synon përafrimin me acquis e BE-së konkretisht me Rregulloren (BE) 2017/2403 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 12 dhjetor 2017 mbi menaxhimin e qëndrueshëm të flotës së jashtme të peshkimit dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 1006/2008, Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 1185/2003 e datës 26 qershor 2003 mbi heqjen e pendëve të peshkaqenëve në bordin e anijeve dhe me Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 1224/2009 e datës 20 nëntor 2009 për krijimin e një sistemi kontrolli të Komunitetit për garantimin e pajtueshmërisë me rregullat e politikës së përbashkët të peshkimit, duke ndryshuar Rregulloret (KE) Nr. 847/96; (KE) Nr. 2371/2002; (KE) Nr. 811/2004; (KE) Nr. 768/2005; (KE) Nr. 2115/2005; (KE) Nr. 2166/2005; (KE) Nr. 388/2006; (KE) Nr. 509/2007; (KE) Nr. 676/2007; (KE) Nr. 1098/2007; (KE) Nr. 1300/2008; (KE) Nr. 1342/2008 dhe që shfuqizon Rregulloren (KEE) Nr. 2847/93; (KE) Nr. 1627/94 dhe (KE) Nr. 1966/2006.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji është konceptuar në 27 nene, si më poshtë:

Neni 1 parashikon disa shtesa dhe ndryshime të nenit 4 të ligjit, përta i përket përkufizimit të termave.

Është shtuar përkufizimi për “anije mbështetëse” që nënkupton një anije të ndryshme nga një mjet lundrues i mbajtur në bord, e cila nuk është e përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në aktivitetet peshkimi, por i shërben një anijeje tjetër për të lehtësuar, ndihmuar ose përgatitur operacionet e peshkimit.

Është riformuluar pika 22/1 “*Infrastruktura e peshkimit*” dhe pika 22/2 “*Infrastruktura që lidhet me peshkimin*” duke përfshirë të gjitha ato pjesë të infrastrukturës të cilat janë në shërbim të peshkimit. Qëllimi është që ky përkufizim të jetë më gjithëpërfshirës.

Është shtuar pika 38/1 “*Masat e ruajtjes dhe menaxhimit*” e cila nënkuptohej në ligj, por nuk kishte një përkufizim të caktuar. Kjo është një kërkesë nga procesi screening.

Shtuar pika 41/1 “*Markatë*” është një treg, qendër ankandi, ose çfarëdolloj strukture tjetër e përhershme ose e përkohshme e cila përdoret për tregtimin me shumicë të produkteve të peshkut. Ky përkufizim është bërë me qëllim unifikimin e termave të ndryshëm të përdorur në këtë ligj.

Shtuar pikat 57/1 dhe 57/2, “*Pendë peshkaqeni*” është çdo pend peshkaqeni, përfshirë këtu edhe pendën kaudale, por duke përjashtuar pendët pektorale të rajave dhe “*Peshkaqen*” është çdo peshk që bën pjesë në klasën “*Elasmobranchii*”.

Pikat 62 dhe 63 janë riformuluar me qëllim që këto kategori të peshkimit të identifikohen sipas llojit të rrjetave që përdorin sesa të gjatësisë së tyre. Kategorizohen si peshkim tregtar profesional ato anije që përdorin rrjeta me tërheqje (fundore dhe pelagjike, veçmas ose së bashku), rrjeta me rrethim, draga hidraulike dhe linje grepash (pallangare), ndërsa si: *peshkim tregtar artizanal* ose *peshkim bregdetar artizanal*, janë ato mjete lundruese të ndryshme nga të parat.

Është shtuar pika 70/1, “*Popullata ndërzonale*” janë popullata peshqish që gjenden brenda Zonës Ekskluzive Ekonomike ose të një zone ngjitur me të.

Është riformuluar pika 108, e nenit 4 “*Zonë e kufizuar e peshkimit*”, është një zonë detare specifike e përcaktuar gjeografikisht brenda një ose më shumë baseneve detare ku të gjitha ose disa aktivitete peshkimi janë të kufizuara ose të ndaluara përkohësisht ose përgjithmonë me qëllim përmirësimin e ruajtjes së burimeve biologjike të gjalla ose mbrojtjen e ekosistemeve detare sipas përcaktimeve të legjislacionit të peshkimit. Ky përkufizim i ri bazohet në ndryshimet e ndodhura në legjislacionin e BE-së duke rritur shkallën e përafrimit.

Pika 110 është riformuluar “*Zonë e mbrojtur peshkimi*” është një zonë detare ku nuk lejohet asnjë lloj aktiviteti peshkimi.

Neni 2 parashikon zëvendësimin e termave “zonë e mbrojtur” me togfjalëshin “zonë e kufizuar” me përjashtim të nenit 12 dhe zëvendësimin e “*inspektorati që mbulon fushën e inspektimit*” me togfjalëshin “*inspektorati që mbulon fushën e peshkimit*”. Legjislacioni i fundit i BE-së po zëvendëson këto terma, gjë që reflektohet edhe në ndryshimet e propozuara në këtë projektligj.

Neni 3 shfuqizon nenin 5 dhe pjesa e shfuqizuar, e përditësuar sipas Rregullores 1380/2013 të Këshillit (KE) i shtohet nenit 23.

Neni 4 riformulon nenin 23 “Politikat e peshkimit”. Është gjykuar që parimet e politikës së peshkimit sipas Rregullores së Parlamentit dhe të Këshillit Evropian 1380/2013 i datës 11 dhjetor 2013 mbi Politikën e Përbashkët të Peshkimit të shtohen te neni përkatës i Politikës së Peshkimit të ligjit, e cila duhet të jetë në përputhje me Politikën e Përbashkët të Peshkimit të BE-së.

Neni 5 parashikon disa shtesa dhe ndryshime të nenit 30, kryesisht në pikën 11 të këtij neni:

- a) me kapacitet peshkimi (prodhimi i tonazhit me fuqinë motorike) më të vogël ose të barabartë me një anije peshkimi me leje të vlefshme peshkimi, si zëvendësim i saj;
- b) të mbytura, të cilat ishin të pajisura me një leje të vlefshme peshkimi në kohën e ngjarjes, si zëvendësim i saj. Në këtë rast kërkesën për leje peshkimi e bën pronari i anijes ose trashëgimtarët e tij;
- c) të rrëmbyera të cilat ishin të pajisura me leje të vlefshme peshkimi në kohën e ndodhjes së ngjarjes. Subjekt i këtij zëvendësimi janë anijet e rrëmbyera pas vitit 2011.
- ç) që ushtrojnë aktivitet peshkimi në detet e hapura, jashtë Detit Mesdhe.

Ndryshimet në pikën 11, të nenit 30 të ligjit kanë për qëllim të hapin lejet e peshkimit por vetëm për anijet që do të peshkojnë jashtë Mesdheut. Anijet shqiptare të peshkimit mund të zhvillojnë aktivitet jashtë Mesdheut dhe peshku i zënë kudo në botë është peshk shqiptar, pasi varet nga flamuri i anijes së peshkimit. Që anijet të zhvillojnë aktivitet në detrat e largët, jashtë Mesdheut, nevojitet që këto anije të jenë më të mëdha dhe të pajisura me aparaturat që mundësojnë lundrimin në distanca të largëta. Për këtë qëllim është e nevojshme të krijohet mundësia që ligji i peshkimit të lejojë futjen e anijeve të reja për peshkim jashtë Mesdheut, ashtu sikurse edhe vetë vendet e BE-së e kanë për flotën e tyre Rregulloren e BE-së 2017/2403 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 12 dhjetor 2017 mbi menaxhimin e qëndrueshëm të flotës së jashtme të peshkimit. Nga flota aktuale janë të pakta anijet e afta që peshkojnë në detet e hapura dhe ky ndryshim mundëson shtimin e tyre me anije të tilla, me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të sektorit.

Neni 6 parashikon shtimin e një dispozite të re “*Peshkimi në detet e hapura*”. Në vazhdim të pikës së mësipërme me qëllim që këto anije të peshkojnë në detet e hapura, duhet të plotësojnë disa kushte të përcaktuara në këtë nen.

Neni 7 riformulon nenin 34 “*Peshkimi jashtë ujërave territoriale*”.

Neni 8 parashikon ndryshime dhe shfuqizim të pikës 3, të nenit 34/1. Është riformuluar pika 1, mënyra e përfshirjes së anijeve të peshkimit bregdetar artizanal në një nga format e organizimit, me qëllim bashkërendimin dhe menaxhimin e peshkimit artizanal në shkallë të vogël.

Neni 9 parashikon disa shtesa dhe ndryshime të nenit 37 duke rritur numrin e specieve të mbrojtura nga peshkimi. Gjithashtu, është shtuar pika 1/1, 1/2 dhe 1/3, që shprehet për ndalimin e heqjes së pendëve të peshkaqenëve, të shitjes dhe hedhjes në treg të tyre si dhe lejimi i prerjes së pjesshme dhe palosjes së pendëve të peshkaqenëve.

Neni 10 parashikon shtesa dhe ndryshime të nenit 61/1.

Është shtuar pika 2 togfjalëshi *“nëpërmjet planeve të prodhimit dhe marketingut”*. Është shtuar pika 2/1, ku shprehet se forma dhe përmbajtja e planeve të prodhimit dhe marketingut miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11 riformulon nenin 64, i cili parashikon transferimin e menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit tek organizatat e peshkimit të njohura nga ministri. Gjithashtu, parashikon parimet dhe rregullat mbi të cilat do të menaxhohet infrastruktura e peshkimit. Këtij neni i janë shtuar pikat 3 dhe 4, të cilat janë hequr nga neni 65 i ligjit.

Neni 12 riformulon titullin I, të kreut VIII *“Menaxhimi i infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur me peshkimin”*.

Neni 13 parashikon riformulimin e nenit 65, për menaxhimin e infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur me peshkimin. Kushtet dhe procedurat e transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit dhe infrastrukturës së lidhur të peshkimit dhe formati tip i kontratës, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 14 parashikon ndryshime të nenit 69.

Është riformuluar pika 1, *“Një anije peshkimi me flamur shqiptar që kryen aktivitet në ujërat shqiptare, autorizohet të kryejë aktivitete të veçanta peshkimi vetëm për aq sa ato tregohen në një autorizim të vlefshëm peshkimi kur peshkimi ose zonat e peshkimit ku autorizohen aktivitetet i nënshtrohen një regjimi sforcoje peshkimi, një plani shumëvjeçar, një zone të kufizuar peshkimi, për qëllime shkencore ose raste të tjera të parashikuara në legjislacionin shqiptar”*.

Është shfuqizuar pika 2. Këto ndryshime vijnë pas procesit të screening duke rritur shkallën e përafrimit.

Neni 15 parashikon shtesa dhe ndryshime të nenit 72.

Është shtuar pika 1/1, “Ministria ngre një sistem monitorimi të anijeve me bazë satelitore për monitorimin efektiv të aktiviteteve të peshkimit të anijeve të peshkimit me flamur shqiptar kudo që mund të jenë ato anije dhe të aktiviteteve të peshkimit të këtyre anijeve në ujërat ndërkombëtare”.

Është riformuluar pika 3, “Ministria siguron që të dhënat e siguruar nga sistemi automatik i identifikimit në anijet e peshkimit i transmetohen QNOD-së dhe Inspektoratit të Peshkimit”.

Është shtuar pika 8/1 dhe 8/2 dhe në pikën 9 është zëvendësuar togfjalëshi “i pikës 1”, me togfjalëshin “i pikave 1 dhe 8/1”.

Këto ndryshime kanë për qëllim të shtojnë detyrimin e pajisjes së anijeve të peshkimit mbi 15 metra me sistemin AIS dhe ndryshimet në këtë nen kanë për qëllim të qartësojnë diferencën midis sistemit VMS tashmë në funksion (sistemi i monitorimit satelitor, pika 1/1) dhe sistemit të ri AIS që vjen si detyrim i pikës 8/1.

Neni 16 është shtuar në nenin 73 pas togfjalëshit “me sistem monitorimi” shtohet “satelitor”.

Neni 17 është zëvendësuar togfjalëshi i pikës 1, të nenit 81 “të paktën 24 orë para mbërritjes së tyre” me togfjalëshin “të paktën 3 (tre) ditë pune përpara momentit të parashikuar të mbërritjes në port”, si një kërkesë e dalë nga procesi i screening.

Neni 18 është shtuar në nenin 109 pika 4 e cila përcakton se mënyra e organizimit dhe funksionimit të tregut të produkteve të peshkimit dhe akuakulturës miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 19 ka riformuluar pikën 3, të nenit 118, si nevojë e dalë nga procesi i screening.

Neni 20 ka ndryshuar neni 121, ku pika 3 shfuqizohet dhe pika 4 riformulohet.

Neni 21 ka riformuluar nenin 127. Përkufizimi aktual në ligjin e peshkimit nuk është në përputhje me Rregulloren Nr. 1005/2008 të BE-së dhe ndryshimi i këtij neni erdhi si pasojë e procesit të screening.

Neni 22 parashikon riformulim të nenit 128 duke rivlerësuar vlerat e masave administrative si dhe hartimin e një metodologjie për përcaktimin e masës administrative. Ky rivlerësim ka për qëllim që të ulë diferencën midis masave administrative më të ulëta dhe atyre më të larta (duke propozuar shpesh një masë me vlerë fikse), ose atje ku kjo nuk është e mundur është shtuar një pikë në këtë nen për përgatitjen e metodologjisë së përcaktimit të vlerës në mënyrë transparente.

Neni 23 ka riformuluar nenin 131 në lidhje me procedurën e ankimit ndaj vendimit të inspektoratit që mbulon fushën e peshkimit.

Neni 24 ka riformuluar nenin 132 në lidhje me ngritjen e Komisionit për Shqyrtimin e Ankimimeve ndaj masave administrative të marra nga inspektorët e peshkimit, gjatë kryerjes së një inspektimi dhe për shqyrtimin e ankesave për lejet e peshkimit.

Neni 25 përmban dispozitën kalimtare, ku specifikohet se anijet e peshkimit duhet të pajisen në bord me sistemin automatik të identifikimit (AIS):

- a) duke filluar nga data 1 janar 2025 për anijet e peshkimit me gjatësi mbi 24 metra;
- b) duke filluar nga data 1 qershor 2025 për anijet e peshkimit me gjatësi 18-24 metra;
- c) duke filluar nga data 1 janar 2026 për anijet e peshkimit me gjatësi 15-18 metra.

Neni 26 parashikon disa shtesa në nenin 135 për miratimin e akteve nënligjore.

Neni 27 është hyrja në fuqi e ligjit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe akuakulturës.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është përgatitur nga grupi i punës ngritur me Urdhrin Nr. 45, datë 26.1.2024, të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk ka efekte financiare në buxhetin e shtetit.

MINISTËR

ANIJA DENAJ